



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i Marketingut dhe Inxhinierisë, në Fakultetin e Biznesit dhe të Drejtësisë, (FBD) shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel akademik me kohë të plotë, të kategorisë lektor:

Kriteret e përgjithshme e të veçanta të kandidatit të kategorisë lektor janë si më poshtë:

I.1. Kriteret e përgjithshme të kategorisë lektor

1. Kandidati duhet të ketë gradën Doktor (lektor);
2. Grada e lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë i njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri;
3. Kandidati të ketë përfunduar studimet universitare (Master i Shkencave dhe Bachelor) dhe ose ekuivalente me të, në fushën e shkencave ekonomike
4. Kandidati të zotërojë të paktën një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Europian;
5. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masa disiplinore të largimit nga puna;
6. Kandidati të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;

I. 2. Kriteret të veçanta për kandidatin e kategorisë lektor janë si më poshtë:

1. Kandidati duhet të ketë gradën Doktor (lektor) në fushën e Marketingut, Menaxhimit ose fusha të përafërta;
2. Kandidati duhet të ketë përvojë në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve (kombëtare dhe ndërkombëtare);
3. Kandidati të ketë eksperiencë jo më pak se pesë vite si lektor i lëndëve të fushës së Marketingut, Menaxhimit (preferohet që disa nga këto lëndë të jetë i gatshëm t'i ofrojë në gjuhën angleze, në përputhje me nevojat e programeve studimore)
4. Preferohen kandidatë të cilët kanë kontribut në zhvillimin dhe rishikimin e kurrikulave si dhe pjesëmarrje në procese të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit.
5. CV e vlerësuar në tërësinë e saj përbën kriter preferencial.

Kandidatët duhet të dorëzojnë, pranë zyrës së protokollit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim (plotësim i formularit të aplikimit, i cili gjendet në faqen: www.uniel.edu.al).
2. Jetëshkrimi (CV).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

3. Kopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave. Diplomat e lëshuara nga Institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga MAS.
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.
5. Kopje e librezës së punës/vërtetim punësimi nga punëdhënësi për ekperiencën e punës
6. Dëshmi e gjuhëve të huaja të noterizuar.
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti).
8. Raport i aftësisë për punë.
9. Fotokopje e letërnjoftimit.
10. Librezë shëndetsore.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (26.01.2026 – 04.02.2026) nga data e shpalljes në www.unie.edu.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *personel akademik*,
Departamenti i Marketingut dhe Inxhinierisë (FBD)
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Biznesit dhe të Drejtësisë. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtrohen intervistës me gojë (09.02.2026 – 20.02.2026). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.